


Nr.regj. 16936/2010



**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Basri Muja nga Mitrovica, për kundërvajtje nga neni 6 paragrafi 2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 15.04.2011 merr këtë:

## AKTVE N D I M

**I PANDEHURI: Basri (Brahim) Muja**, i lindur më 1968 në Mitrovicë, ku edhe ka vendbanimin në rrugën "Adem Boletini" p.n., i punësuar si Ushtrues Detyre të Drejtorit të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, i gjendjes së mirë ekonomike,

### Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si UD Drejtor i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës në Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor, deri më datën 31.03.2011

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6. 2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

## D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro), të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi ky aktvendim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave të KGJK-së No. 1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga gjykata, një kopje duhet të kthehet në gjykatë. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar komfor nenit 5 të LK, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditë, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgu.

Komfor nenit 109 të LK, në emër të paushallit gjyqësor, i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 10 Euro në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'u dorëzohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

## A r s y t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën 01/2303/2010 me datë 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë i njëjti nuk e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsion formularin mbi deklarin e gjendjes së pasurisë deri më datën 31 mars të vitit 2010.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk konteston faktin se nëpërmjet postës elektronike nga Agjencia Kundër Korrupsion, para datës 31.03.2010, ka pranuar formularin për deklarin e pasurisë të cilin është dashur ta plotësoj. Në vazhdim i pandehuri sqaron se nga data 23.03.2009 me Vendim të MASHT nr. 65/09, ishte caktuar si UD i Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim deri në zgjedhjen sipas procedurës së konkursit, kurse më vonë, saktësisht me datë 02.04.2010 kishte nënshkruar kontratën e re të punës në pozitën e Ekspertit për vlerësim dhe akreditim, ku do të fillonte punën me datë 14.04.2010 dhe e

njëjta do të mbaron me datë 13.04.2013. Pra, i pandehuri thekson se për shkak se e kishte ndërruar vendin e punës, nuk e kishte ditur se duhet të deklarojë pasurinë.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit dhe shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, gjyqtarja në masë të njohurisë vërtetoi ekzistencën e veprës kundërvajtëse, ngase i pandehuri pa të drejtë shmanget nga përgjegjësia për deklarim të pasurisë, duke u arsyetuar me faktin se nga prilli i vitit 2010 ka ushtruar detyrën e ekspertit e cila nuk e obligon për të deklaruar pasurinë, mirëpo i pandehuri është dashur që deri më datën 31.03.2010 të deklarojë pasurinë meqë ligjërisht pozita e UD të drejtorit si zyrtar i lartë, që ai e ka ushtruar deri më atëherë e ka obliguar të bëjë deklarimin e pasurisë, sepse i njëjti ka pasur autorizime dhe obligime të njëjta sikur drejtori. Andaj, gjyqtarja të pandehurin e shpall përgjegjës për këtë kundërvajtje të njëjtin e dënoi me gjobën e paraparë ligjore.

Gjatë shqyrtimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkeljes sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik si dhe personalitetin e tij, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. Regj.16936/2010, datë 15.04.2011

Gjyqtarja

Suzana Çerkini

**KESHILLA JURIDIKE**, Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga data e përfundimit të njëjtit, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, pa falje.

